

PROCEVERBAL
nga seanca 21. e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele
mbajtur më 1.6.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, mr. Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Të punësuar nga shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunović, Jeton Ismaili, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e 21-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 11:05 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 7 vota "pro", miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 20-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 21.5.2026.
2. Propozim-aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV Shenja ShPKNJ P Shkup.
3. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Riparim, servisim dhe mirëmbajtje e ashensorëve dhe platformave.
4. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli shqyrtoi dhe, me 6 vota "pro" dhe një abstenim nga Petar Xhurovski, miratoi Procesverbalin e seancës së 20-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të mbajtur më 21.5.2026, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, arsyetoi propozimin për miratimin e Aktvendimit për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv

të ShTR TV Shenja ShPKNjP Shkup. Ai informoi se, pas fillimit të procedurës, transmetuesi plotësisht ka paguar kompensimin vjetor të lejes në shumë prej 4.029.334,00 denarë. Duke pasur parasysh se detyrimi është përmbushur plotësisht, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit, propozohet të ndërpritet procedura për heqjen e lejes.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes për transmetim televiziv të ShTR TV Shenja ShPKNjP Shkup, PA1 nr. 08-778 të datës 7.9.2023.

Në përputhje me Njoftimin për pagesën e kryer nr. 05-2151/2 të datës 27.5.2026, ShTR TV Shenja ShPKNjP Shkup, e pagoi plotësisht kompensimin vjetor të lejes për transmetim televiziv, në përputhje me faturën nr.2026-100-0129 të datës 9.4.2026.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në faqen e internetit të Agjencisë.

Pika 3

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik të shërbimit - riparim, servisim dhe mirëmbajtje të ashensorëve dhe platformave. Ai theksoi se problemet me funksionimin e ashensorëve vazhdojnë edhe më tej, prandaj është e nevojshme që menjëherë të sigurohet operator i ri ekonomik për mirëmbajtjen e tyre. Njëkohësisht, ai informoi se me operatorin aktual është nënshkruar marrëveshje për ndërprerjen e kontratës për mirëmbajtje dhe riparimin e ashensorëve. Për këto arsye, propozohet të zbatohet procedura e re për furnizim publik, në pritjen që brenda afatit të përcaktuar me ligj, të zgjidhet operator ekonomik i cili do të sigurojë mirëmbajtje më cilësore dhe të vazhdueshme të ashensorëve dhe platformës, me çka do të tejkalohen problemet aktuale në funksionimin e tyre.

Kryetari i Këshillit, Sasho Stefanovski, u pajtua se situata me ashensorët dhe platformën është serioze dhe kërkon veprim urgjent. Ai theksoi gjithashtu se platforma në ditën e mbajtjes së seancës nuk ishte në funksion, që konfirmon shtesë nevojën për zgjidhjen urgjente të problemit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi drejtorin e Agjencisë për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: riparim, servisim dhe mirëmbajtje të ashensorëve dhe platformës.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik - shërbim: riparim, servisim dhe mirëmbajtje e ashensorëve dhe platformës është parashikuar dhe është në përputhje me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2026 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, (tekst i pastruar) nr. 05-2219/1 i datës 22.5.2026, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2026.

Pika 4

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**

Përktheu: Antoneta Shabani